



**BASHKIA  
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE**

**Drejtuar: operatorit ekonomike “EuroMega 2010” shpk  
Adresa: Tirane Preze Fshati Ahemtaq, prane firmes Ital Kon.**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” “Blerje materiale pastrimi për Bashkinë e Tiranës për vitin 2018”.**

**Referenca e procedures: REF-83942-08-28-2018**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Blerje materiale pastrimi për Bashkinë e Tiranës për vitin 2018”.**

**Fondi limit: 1.213.760 (një milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.**

**Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr.132, datë 21.12.2017 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për Vitin 2018”.**

**Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 20 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.**

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 10.09.2018, Ora: 13:00.**

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 35 datë 03.09.2018.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara.

**1. Operatori ekonomik “EuroMega 2010 shp.k**

**NUIS K91624505A**

Vlera e ofertës – **980.030 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë e tridhjetë) lekë pa**

TVSH.

**2. Operatori ekonomik “Atlantik 3” shpk NUIS K22218003V**

Vlera e ofertës – **1.210.000** (një milion e dyqind e dhjetë mijë) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “Stargate” shpk NUIS L72218034K**

Vlera e ofertës – **1.050.000** (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomike “Anbim” shpk NUIS L81618008J**

Vlera e ofertës – **0** lekë pa TVSH.

**Janë s’kualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

- Operatori ekonomik “Stargate” shpk nuk kualifikohet.
- Operatori ekonomik “Anbim” shpk nuk kualifikohet.
- Operatori ekonomik “Atlantik 3” shpk nuk kualifikohet.

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Operatori ekonomik “Anbim” shpk**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Anbim” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor, teknik, ekonomik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë. Gjithashtu nuk ka paraqitur as oferte ekonomike dhe nuk ka paraqitur as mostrat e kerkuara tek kriteret e vecanta per kualifikim.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave..

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik shoqëria “Anbim” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik, ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2. Operatori ekonomik “Stargate” shpk**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **1.050.000** (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë. Çmimi total i

ofertës me tvsh = **1.260.000** (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 20 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

1. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tirane, ne kriteret per kualifikim pika 2. është përcaktuar se:

*“Operatori ekonomik ne rastin kur nuk është prodhues duhet te paraqese **autorizim prodhuesi/distributori** per objektin e prokurimit ( loti i pare), per mallrat e kerkuara. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij”.*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave nga shqyrtimi i bere dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik Stargate shpk konstatoi se ky operator nuk ka paraqitur **autorizim prodhuesi/distributori** per objektin e prokurimit cka bie ne kundërshtim me kriterin sa me siper cituar.

Ne vijim nga Autoriteti Kontraktor ne piken 5 eshte percaktuar se:

*“Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Çertifikatat Ecolabel EU ose ekuivalente vetem per produktet e detergjenteve, per mallrat e kerkuar me keto standarte te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizimi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise”.*

Nga shqyrtimi i bere dokumentacionit te paraqitur nga shoqeria Stargate shpk u konstatua se nuk eshte paraqitur certifikata sa me siper cituar.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tirane, ne kriteret per kualifikim pika 4 është përcaktuar se:

*“Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Çertifikatat e prodhuesit vetem per produktet e detergjenteve si Certifikaten e cilesise ISO 9001:2015, Certifikaten e Ambjentit ISO 14001:2015, dhe Certifikaten e Shendetit dhe Sigurise ne pune ISO 18001:2007, brenda afatit te vlefshmerise”.*

Nga shqyrtimi i bere dokumentacionit te paraqitur nga shoqeria Stargate shpk u konstatua se nuk jane paraqitur Isot e prodhuesit sikunder jane kerkuar ne percaktimin e bere tek kriteri i mesiperm.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tirane, ne kriteret per kualifikim pika 6 është përcaktuar se:

*“Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogjet duke evidentuar produktin dhe skedat teknike (MSDS-te) te detergjenteve ku te dallohet qarte perputhja e te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara me produktet e ofruara. Katalogjet duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe. Te gjitha te dhenat e katalogjet dhe skedat teknike te detergjenteve qe do te paraqiten duhet te jene te verifikueshme online ne faqen zyrtare te prodhuesve.*

Nga shqyrtimi i bere dokumentacionit te paraqitur nga shoqeria Stargate u konstatua se nuk jane paraqitur katalogjet cka bie ndesh me kriterin sa me siper cituar

Ne vijim tek kriteret e vecanta per kuakifikim pika 3.1 eshte kerkuar si me poshte vijon:

*”Vërtetim lëshuar nga Komuna ose Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2018 sipas legjislacionit ne fuqi per taksat dhe tarifat vendore;*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR". Nga shqyrtimi i bere dokumentacionit te paraqitur nga shoqeria Stargate u konstatua se eshte paraqitur vertetim per shlyerjen e detyrimeve vendore per vitin 2017 jo per vitin 2018 sikunder eshte kerkuar tek kriteri sa me siper cituar.*

Ne nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, **pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese**". Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, 7 parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### 3. Operatori ekonomik "Atlantik 3" shpk

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **1.210.000** (një milion e dyqind e dhjetë mijë) lekë. Çmimi total i ofertës me tvsh = **1.452.000** (një milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë. Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 20 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

- Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tirane, ne kriteret per kualifikim pika 6 është përcaktuar se:

"Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese ditën e hapjes se ofertes mostra per te gjithë artikujt e kerkuar ne preventiv per lotin e pare".

**Mostrat duhet te jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara dhe te paraqitura ne oferten teknike. Mosparaqitja e mostrave, dorazi, ne ditën e hapjes se ofertave eshte kusht skualifikues.**

Komisioni i Vlerësimit te Ofertave konstatoi se operatori ekonomik "Atlantik 3" ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave nuk ka paraqitur mostrat duke mos plotesuar keshtu kriterin sa me siper cituar. Komisioni i Vlerësimit te Ofertave duke qene se mospermbushja e ketij kriteri eshte kusht per s'kualifikim vendosi per ekonomi procedure te mos i hyje shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur ne SPE duke qene se pozita e kesaj shoqerie nuk ndryshon pra mbetet i s'kualifikuar.

Ne nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, **pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese**". Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006

*“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “EuroMega 2010”, shpk** me adresë: **Adresa: Tirane Preze Fshati Ahemtaq, prane firmes Ital Kon.** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **980.030 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë e tridhjetë)** lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 13.09.2018**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

